

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-09-0060

Në lëndën e SCEL-09-0009 [REDACTED]

[REDACTED]
Rruga [REDACTED]

Ankuesi Nr.23/Apeluesi

Vs

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Rruga Ilir Konushevci, Nr.8, Prishtinë

E Paditura

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Ankuesit nr. 23 kundër Aktvendimit të DHPGJS-së së datës 26 gusht 2009, SCC-09-009, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 maj 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

Ankesa është e bazuar.

Anulohet aktvendimi i DHPGJS-së i datës 26 gusht 2009, SCC-09-009.

Urdhërohet Trupi Gjykues që të rigjykojë padinë.

Arsyet Ligjore:

Lista (finale) e punëtorëve me të drejta legjitime (shih nenin 67.5 të UA të UNMIK-ut 2008/6 lidhur me nenin 10.3 të RREG se UNMIK-ut 2003/13) për NSH [REDACTED] në Prizren është publikuar më 21, 22 dhe 23 maj 2009, në të

përditshmet "Koha Ditore", "Kosova Sot" dhe "InfoPress", në gjuhën shqipe, dhe më 21, 23 dhe 24 maj 2009 në të përditshmet "Blic" (Beograd) dhe "Vijesti", (Podgoricë), të dyja në gjuhën serbe. Afati kohor prej 20 ditësh për të ushtruar ankesë pranë DHPGJS-së, lidhur me listën (neni 67.6 të UA të UNMIK-ut 2008/6 lidhur me nenin 10.6 RREG të UNMIK-ut 2003/13) ishte 13 qershor 2009.

Më 15 korrik 2009, Ankuesi (personalisht) e ushtroi një ankesë pranë DHPGJS-së për tu përfshirë në listë, duke pohuar se ai veç kishte ushtruar një ankesë pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) më 10 maj 2007 pas publikimit të listës (së parë) më 25 prill 2007 (vërejtje nga Kolegji i Ankesave: kjo është bërë lidhur me veprimtarinë e privatizimit që është kryer nga AKM-ja në atë kohë), "brenda afatit kohor të paraparë me ligj", por nuk ka marrë asnje përgjigje, edhe pse është pritur. Ai pohon me tutje se nuk e ka ditur për publikimin e listës së re nga AKP-ja që ka përcaktuar një afat të ri kohor, pasi që nuk ka qenë në gjendje të blejë gazeta çdo ditë; për shkak të shëndetit të tij të dobët dhe të gruas së tij, ata e kanë kaluar "shumicën e kohës" në fshatin [REDACTED] "ku nuk shiten gazetat", dhe nuk transmetohet sinjali televiziv. Së fundi, si pjesëtar i minoritetit boshnjak, ai nuk është lajmëruar aspak si duhet pasi që lista nuk është publikuar në ndonjë gazetë në gjuhën boshnjake. Ai është informuar nga kolegët për publikimin e listës finale (të dytë). Për këto arsyе, ai pohon se nuk ka mundur të parashtrojë ankesë më herët se 32 ditë pas afatit. Ai gjithashtu e diskuton çështjen e meritave, pse – sipas mendimit të tij – ai do të duhej të përfshihej në listë. Në bazë të dhënave që janë dhënë, ai kërkon të merren parasysh argumentet e tij mbi meritat, edhe pse është dorëzuar vonë, dhe që ai të përfshihet në listë.

AKP-ja ka kërkuar që ankesa të hedhet poshtë si e paafatshme.

Përmes aktvendimit të kontestuar të datës 26 gusht 2009, Trupi Gjyques i DJPGJS-se e ka refuzuar ankesën si të papranueshme. Në arsyetimin e tij ligjor, aktvendimi i referohet dispozitave të lartpërmendura ligjore që e parashohin afatin prej 20 ditësh për ushtrimin e ankesës, dhe nenet 28.2 (d) dhe 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Pasi që ka skaduar afati, ankesa është dashur të refuzohet.

Ankuesi, në ankesën e tij të parashtruar, ka kërkuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së ta "anulojë" aktvendimin dhe t'ia njeh atij të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi.

Ankesa është e bazuar.

Ankuesi përsërit argumentet e dhëna në shkallën e parë, kryesisht duke pohuar se për shkak të mos përgjigjes nga AKM-ja në ankesën e tij në vitin 2007, dhe për shkak të rrethanave lidhur me publikimin e listës finale nga AKP-ja në vitin 2009, ankesa e tij e fundit duhet të konsiderohet e afatshme dhe e vlefshme, dhe është dashur të rezultonte me përfshirjen e tij në listë.

Në ankesën e tij në shkallën e parë, Ankuesi në mënyrë eksplikite nuk e ka kontestuar parashtrimin e vonuar (prej 32 ditësh, përderisa tani ai pohon se afati ka skaduar për vetëm dy ditë; në këtë fazë, nuk është e rëndësishme në të vërtetë se për sa ditë ka skaduar afati). Sidoqoftë, ai jo vetëm që ka argumentuar për meritat e lëndës, por njëkohësisht ka dhënë arsyë të cilat ai i ka konsideruar valide se pse nuk ka qenë në gjendje ta ushtrojë ankesën me kohë. Deri më tanë, kjo ankesë është dashur të kuptohej si një propozim për kthimin në gjendjen e mëparshme, drejtuar Trupit Gjykues (shih nenet 117, 118 të Kodit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 4/77-1478, e ndryshuar, lidhur me nenin 70.3 [a] të UA të UNMIK-ut 2008/6).

Duke e hedhur poshtë ankesën si të paafatshme pa ju referuar argumenteve në ankesë sa i përket parashtrimit të vonuar të saj, Trupi Gjykues nuk e ka shqyrtuar fare propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme. Prandaj, hedhja poshtë si e paafatshme ishte e nxituar: aktvendimi i kontestuar nuk mund të vazhdohet si i tillë.

I mbetet Trupit Gjykues (përsëri) që të shqyrtojë nëse arsyet e dhëna në ankesë/propozim kanë bazë valide për parashtrim të vonuar të ankesës; në ato baza do të duhet të vendos (përsëri) nëse ankesa do të konsiderohet e paafatshme dhe si rezultat e papranueshme. Nëse vjen në përfundim se ka pasur arsyë të justifikueshme se pse ankesa është parashtruar shumë vonë, do të duhet t'ia kthejë Apeluesit gjendjen e mëparshme, dhe të merret pastaj me meritat e ankesës. Nëse jo, propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme do

të duhej të refuzohej si i pabazuar, dhe vet ankesa të hedhet poshtë si e paafatshme (përsëri).

Në këtë moment, Kolegji i Ankesave, si gjykatë e shkallës së dytë nuk është në pozicion të merret me meritat e lëndës (përjashtimi i Ankuesit nga lista), pasi që kjo do t'ia mohonte të drejtën e palëve nga një shkallë.

Taksat/Shpenzimet gjyqësore:

Procedura në lëndët që kanë të bëjnë me Listën e Punëtorëve Legjitim (neni 67 i UA të UNMIK-ut 2008/6) janë – me përjashtim të disa taksave të caktuara gjyqësore që këtu nuk janë relevante – janë falas (shih Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore të nxjerra nga Dhomë e Posacme, në fuqi që nga 190 marsi 2010, në pajtim me nenin 57.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6).

Nëse shpenzimet rriten gjatë procedurës së mëtutjeshme gjyqësore (në veçanti nga ana e të Paditurit), i mbetet Trupit Gjykues t'i alokojë këto shpenzime mes palëve në aktvendimin e tij përfundimtar (shih nenin 11 RREG 2008/4 dhe nenin 66 të UA të UNMIK-ut 2008/6).

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it (nënshkruar)

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it (nënshkruar)

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it (nënshkruar)

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it (nënshkruar)